

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Evadim mbetjeje spitalore për DSR Dibër.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV Mbledhja, transporti dhe asgjësimi i mbetjeje spitalore - 90524400-0 Mbledhja, transporti dhe asgjësimi i mbetjeje spitalore

Fondi limit i procedurës: 6,486,240 (gjashtë milion e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e dyzet) lekë, pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në përputhje me legjislacionin e posaçëm për objektin e prokurimit, si më poshtë:

- Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeje”, i ndryshuar;
- Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar,
- VKM nr. 798, datë 29.09.2010, “Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeje spitalore”;
- VKM nr. 229, datë 23.04.2014, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeje jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”;
- VKM nr. 371, datë 11.06.2014, “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeje të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre”;
- VKM Nr. 402, datë 30.06.2021, “Për miratimin e katalogut të mbetjeje”;
- Urdhrit Nr. 135, datë 16.4.2015 “Për miratimin e mënyrës së administrimit të formatit të regjistrit të transfertave individuale dhe të regjistrit kombëtar të transfertave, si dhe mënyrën e administrimit të tyre”

Autoriteti/enti kontraktor **“Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a”** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Për metoda dhe teknologji të trajtimit të përcaktuara në Ligjin Nr. 10448, date 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, në VKM nr.798, datë 29.9.2010 “Për miratimin e

rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore” dhe në Termat e Referencës së DST (përveç incenerimit), ose teknologji ekuivalente, Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesë:

1.a Leje mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) ose të tipit B (me kod III.1.B) së bashku me Akt Miratimin përkatës, si dhe

1.b Licensën përkatëse të kategorisë III.2.B (*Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore*)

që të përfshijnë kodet e mbetjeve të rrezikshme si më poshtë:

- **18 01 01** - Bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 01 03);
- **18 01 03** - Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet;
- **18 01 04** - Mbetjet e buta (grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave nuk kërkon trajtim të veçantë për parandalimin e infeksioneve).

2.1.2 Për metodën dhe teknologjinë e trajtimit ME INCENERIM, Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesë:

2.a Leje mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) së bashku me Akt Miratimin përkatës si dhe

2.b Licensën përkatëse të kategorisë III.2.B (*Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore*) ku të përfshihen kodet e mbetjeve të rrezikshme si më poshtë:

- **18 01 02** - Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03);

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe në mbështetje të pikës 5 Menaxhimi i Mbetjeve të Shtojcës 1 Lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C në varësi të kapacitetit prodhues kufi të Ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, VKM Nr. 798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores, Për administrimin e mbetjeve spitalore”, VKM Nr. 402, datë 30.06.2021, “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”, Udhëzuesi Kombëtar “Për Menaxhimin e Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore” dhe sipas përcaktimeve të bëra në Udhëzuesin Kombëtar “Administrimi i sigurt i Mbetjeve Spitalore”, Ligjit Nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar dhe VKM Nr. 538 datë 26.05.2009 “Për licensat dhe lejet, që trajtohen nga/apo nëpërmjet QKB dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar.

2.1.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Akt Miratimin Higjieno –Sanitar respektiv për objektet ku ushtron aktivitetin e trajtimit të mbetjeve spitalore, të lëshuar nga ISHSH (Inspektorati Shëndetësor Shtetëror).

Argumentimi: Ky kriter bazohet në kërkesat e nenit 10 të Ligjit Nr. 7643 datë 12.12.1992 “Për Inspektimin Sanitar” i ndryshuar, dhe në nenin 10.3 të Kreut IV “Leja Mjedisore dhe Akt Miratimi Higjieno – Sanitar” të VKM Nr. 798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore”, ku parashikohet: “10.3. Inspektorati Sanitar Shtetëror, pas ekspertimit higjieno-shëndetësor, lëshon akt-miratim higjieno-sanitar për ushtrimin e veprimtarisë”.

2.1.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a. Vërtetim që operatori ka kryer tarifën vjetore të Lejes Mjedisore, pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në zbatim të VKM nr. 417, datë 25.06.2014, “Për Miratimin e Tarifave të lejeve të Mjedisit”.
- b. Vërtetim që operatori nuk ka masë administrative në fuqi nga strukturat inspektuese të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në zbatim të Ligj Nr.10433 datë 16.06.2011 “Per Inspektimin ne Republikën e Shqiperise”, Ligjit “Për Lejet e Mjedisit” Nr.10448 datë 14.07.2011 si dhe LIGJ Nr.10463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”.

Argumentimi: Këto kërkesa vendosen në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Kërkesa për paraqitjen e vërtetimeve të sipërcituara sigurojnë AK operatori ekonomik kryen veprimtarinë e tij, lidhur me objektin e prokurimit në përputhje me dispozitat ligjore.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 datë 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, është vendosur me qëllim sigurimin e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi, si dhe AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 55, pika 4/b në kushtet kur kjo procedurë prokurimi është procedurë e thjeshtuar të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Vlera e kërkuar është shërben kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori duhet të disponojë 1 automjet për transportin e mbetjeve spitalore, sipas specifikimeve teknike dhe termave të referencës, të shërbimit objekt prokurimi.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesin dokumentet e mëposhtme provuese:

- dokumentacion për mjetin në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).
- Leja e qarkullimit të mjetit, *Akt – kolaudimi, Polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet së bashku me Akt -Miratimet Higjenosanitare, Foto të mjeteve ku të duket qartë targa dhe sinjalistika përkatëse.*

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Ky kriter vendoset në përputhje me pikën 4, të nenit të 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 4/ç e nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Duke marrë në konsideratë faktin se shërbimi objekt i kësaj procedure prokurimi parashikon ndër elementet e tij edhe transportin nga AK në ambientet e trajtimit të operatorit ekonomik, si dhe të produkti final nga ambientet e operatorit drejt landfillit, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion mjetet e nevojshme për të përmbushur kontratën me qëllim ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Numri i kërkuar i mjeteve është minimal, me qëllim që transporti i konteniereve të kryhet në mënyrë që të sigurohet integriteti dhe pastërtia e tyre, në përputhje me rregullat e higjenes dhe sigurisë, duke qenë se në specifikimet teknike dhe termat e referencës është e përcaktuar se duhet të sigurohet grumbullimi i konteniereve me mbetje në pikat e përkohshme të magazinimit të autoriteteve shëndetësore si dhe transportin e tyre në impiantin e trajtimit me mjetet e posaçme të transportit.

2.3.3 Operatorët ekonomikë duhet të kenë të punësuar, 7 (shtatë) punonjës të punësuar për realizimin e kontratës/ava që do të lidhen në zbatim të marrëveshjes kuadër, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës Përgjegjës shërbimi
- 1 (një) punonjës shofer
- 2 (dy) punonjës shërbimi (ngarkim/ shkarkim)
- 3 (tre) punonjës për operimin e impianteve dhe makinerive

Për punonjësit e kërkuar me lart, duhet të paraqiten dokumentat:

a. Për Përgjegjësin e Shërbimit:

Përgjegjësi i shërbimit duhet të jetë Inxhinier Mjedisi/Ekspert Mjedisi dhe për këtë punonjës duhet të paraqitet:

- Diplomë me profesion Inxhinier Mjedisi/dhe/ose Certifikatë “Për Vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditim mjedisor”;
- Kontratë pune (e vlefshme), si Përgjegjës shërbimi;
- formularin E-sig i listëpagesave për muajin e fundit

b. Për punonjësit shofer

- Kontratë pune përkatëse, (e vlefshme)
- Leje Drejtimi

c. Për punonjësit e shërbimit (ngarkim/shkarkim) dhe punonjësit për operimin e impianteve dhe makinerive të paraqitet:

- Kontratë pune përkatëse, (e vlefshme)

Ky Kriter konsiderohet i permbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Bazuar në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikave 4/b dhe 4/c të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pra që kanë në dispozicion për përmbushjen e kësaj kontrate.

Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike, termave të referencës, proceset e realizimit të shërbimit objekt prokurimi.

Përgjegjësi i shërbimit nevojitet për organizimin, drejtimin, ndarjen dhe mbikëqyrjen e proceseve të shërbimit, si dhe përgjigjet për zbatimin e të gjitha detyrave dhe fazave të shërbimit, në përputhje me specifikimet teknike, termat e referencës, rregullat dhe standartet ligjore të zbatueshme në fuqi. Profili i kërkuar për përgjegjësin e shërbimit lidhet me faktin se një inxhinier mjedis/ekspert mjedis ka ekspertizën e duhur për të analizuar ndikimet e ndryshme që mund të sjellë trajtimi i mbetjeve të rrezikshme në mjedis, duke përfshirë ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës. Inxhinieri i mjedisit luan një rol kryesor në implementimin e standarteve mjedisore, monitorimin e emetimeve dhe kontrollit të ndotjes, si dhe në planifikimin e mergjencave mjedisore që mund të ndodhin.

Nisur nga analizimi i specifikimeve teknike dhe termave të referencës, si dhe duke vlerësuar se ndër proceset e punës është edhe grumbullimi i kontenierëve me mbetje në pikat e përkohshme të magazinimit të autoriteteve shëndetësore, ngarkimin dhe shkarkimin e koshave/kontenierëve në dhe nga makina e grumbullimit janë kërkuar punëtorët ndihmës dhe punëtorët për operimin e impianteve dhe makinerive që do të përdoren.

Numri i punonjësve është vlerësuar i tillë në përputhje me proceset e punës dhe detyrat që do të kryhen, në përputhje me specifikimet teknike dhe termat e referencës.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

2.3.4. Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera/përdorim, apo nëpërmjet çdo mënyre posedimi të njohur nga ligji, impiant/e, makineritë e mëposhtme që të mundësojë trajtimin e të gjitha kategorive të mbetjeve objekt prokurimi, sipas Ligjit Nr.10463 date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, si dhe të VKM-se për miratimin e rregullores “Për menaxhimin e mbetjeve spitalore”, (*Rregullorja*) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, si më poshtë:

- a. Impiant për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) - cope 1
- b. Impiant për asgjësimin me incenerim - cope 1
- c. Makineri për larjen e kontenierëve cope 1

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentet e mëposhtme provuese:

- a. Dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë, huapërdorjes ose të marrjes me qera të pajisjes (ku afati i marrjes me qera/përdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi);
- b. Të jenë të pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër;
- c. Katalog ose skede teknike ose çdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerisë;
- d. Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerisë.

Shënim: Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e të dhënave konkrete për secilën pajisje (përfshirë edhe ato back up), nëpërmjet formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST, duke përfshirë të dhënat si vijon: emërtimi i impiantit / përcaktimi si primar apo back up / modeli / rrymat e mbetjeve që trajton dhe/ose asgjëson / Leja dhe Licenca përkatëse ku janë të përfshirë (nga ato të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër.

Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Në bazë të Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, VKM nr. 798, datë 29.09.2010, “Për miratimin e rregullores, ‘Për administrimin e mbetjeve spitalore’, VKM Nr. 402, datë 30.06.2021, “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”, impiantet për realizimin e trajtimit të kategorive të caktuara të mbetjeve spitalore, janë pajisjet baze për realizimin me sukses të këtij shërbimi.

Pasqyrimi në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 vërtetojnë se këto pajisje janë të licencuara për realizimin e procesit të trajtimit të mbetjeve nga organi kompetent. Ky certifikim është detyrim ligjor për të gjitha pajisjet të cilat kryejnë këto lloj procesesh në territorin e RSH dhe jo për pronarin apo personin e trete, ndaj kërkesa është e domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit në fjalë. Fokusi i kësaj kërkesë është tek impianti dhe jo tek personat e trete të cilët japin me qera apo huapërdorje.

Katalog ose skede teknike ose çdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerisë, si dhe Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerisë provon përputhshmërinë e tyre me specifikimet teknike të kërkuara.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesë: kontratë të lidhur me një subjekt të lejuar nga AKM për depozitimin e produktit final që del nga asgjësimi/trajtimi, e cila duhet të jetë aktive dhe e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave. Subjekti në fjalë duhet të jetë i autorizuar në Lejen Mjedisore përkatëse për të pranuar produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologjinë pa djegie me kodin 19 01 dhe produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologji me sterilizim me kodin 19 03.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në VKM Nr. 402, datë 30.06.2021, “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”, si dhe duke qenë se në baze të VKM nr. 798, datë 29.09.2010, “Për miratimin e rregullores, ‘Për administrimin e mbetjeve spitalore’”, strukturat spitalore si krijues të mbetjeve janë përgjegjës deri në hallkën e fundit të asgjësimit të mbetjeve spitalore që krijojnë, AK kërkon që operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratë të lidhur me subjekt të autorizuar sipas ligjit për depozitimin e produktit final respektiv që del nga proceset e trajtimit/asgjësimit, e cila duhet të jetë aktive dhe e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave dhe në vazhdimësi të kësaj marrëveshje deri në përfundim të kontratës së realizimit të kontratës.

Këto dokumente kërkohen me qëllim realizimin me sukses të asgjësimit final të mbetjeve si element mjaft i rëndësishëm i procesit ku dokumentohet që OE është në këtë fushë aktiviteti dhe e kryen këtë lloj shërbimi.

2.3.6 Operatori duhet të paraqesë për secilin lloj kontenitori sipas standardeve dhe kërkesave të Specifikimeve Teknike dhe Termave të Referencës:

- Katalog ose skedë teknike,
- Vetëdeklarim për certifikim dhe aprovim të tipit të ambalazhit për secilin lloj kontenitori (i ripërdorshëm ose njëpërdorimësh) referuar VKM nr. 798, datë 29.09.2010, “Për miratimin e rregullores, ‘Për administrimin e mbetjeve spitalore’”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikës 4/ç nenit 41, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion mjetet dhe pajisjet për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Në bazë të Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, VKM nr. 798, datë 29.09.2010, “Për miratimin e rregullores, ‘Për administrimin e mbetjeve spitalore’”, VKM Nr. 402, datë 30.06.2021, “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”, kontenitorët e mbetjeve spitalore janë elemente të domosdoshëm në proceset e menaxhimit të evadimit të mbetjeve spitalore si për mbledhjen, izolimin, grumbullimin, dhe transportimin e tyre.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë çertifikatë (të vlefshme dhe në përputhje me objektin e prokurimit), si më poshtë:

- SSH EN ISO 14001 “Sisteme të menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalente/të barazvlefshme;
- SSH EN ISO 9001 “Sisteme të menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalente/të barazvlefshme;
- SSH EN ISO 45001 “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalente/të barazvlefshme.

Çertifikatat përkatëse, duhet të jenë të lëshuara nga organet e vlerësimit të konformitetit, të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, dhe të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

- Standarti ISO 9001 "Sistemi i menaxhimit të cilësisë" – Ky standard është i nevojshëm pasi siguron se operatori ekonomik ka një sistem të strukturuar menaxhimi për cilësinë e vazhdueshme të shërbimit objeKT prokurimi. Pajisja me këtë standard garanton që proceset e realizimit të shërbimit do të kryhen në mënyrë të kontrolluar, të dokumentuar, duke minimizuar gabimet/neglizhencat gjatë trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve.
- Standarti 14001 mbi "Sistemet e menaxhimit të mjedisit" – është vendosur si kriter duke marrë në konsideratë faktin që ky Standardi është një sistem sistematik dhe i orientuar drejt procesit të menaxhimit të cilësisë për të kontrolluar impaktet e rëndësishme të aktiviteteve të biznesit në mjedis, si dhe duke vlerësuar se objekti i prokurimit përfshin grumbullimin, trajtimin, transportimin, asgjësimin e mbetjeve spitalore. Pajisja e operatorit ekonomik me këtë standard është një tregues se ofertuesi është i aftë të identifikojë, kontrollojë dhe minimizojë ndikimin e tij në mjedis gjatë realizimit të shërbimeve objekt prokurimi.
- Standarti ISO 45001 mbi "Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë" është vendosur si kriter me qëllim që AK të sigurohet që ofertuesi kryen shërbimin në përputhje me standartet e kërkuara sa i takon shëndetit dhe sigurisë në punë. Është një tregues që operatori mbron punonjësit nga rreziqet biologjike, kimike dhe fizike që lidhen me trajtimin e mbetjeve të rrezikshme, si dhe siguron trajnime, pajisje mbrojtëse, protokolle sigurie dhe masa prandaluese për aksidente që mund të ndodhin gjatë realizimit të shërbimeve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, termat e referencës për realizimin e shërbimit objekt prokurimi, përlllogaritja e fondit limit janë përcjellë pranë OBP, të hartuara nga grupi i punës i caktuara nga titullari i autoritetit kontraktor "**Drejtoria e Spitalit Rajonal të Dibrës**", për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 "*Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore "Operatori i Blerjeve të Përqëndruara" Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise*", i ndryshuar.

Njësia e prokurimit